



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr.1437 Prot.

Tiranë, më 22.07.2026

V E N D I M

Nr. 205, datë 22.07.2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 320 Regj., datë 16.12.2025, e paraqitur nga z. V.Ç kundër Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a², në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, “aftësisë së kufizuar” dhe “bindjeve politike/shprehjes së lirë të mendimit politik”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës ankuesi V.Ç , parashtron, se ushtron detyrën si inspektor pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, me kontratë pune të lidhur që në janar të vitit 2001 e më pas të ndryshuar më datë 01.01.2023. Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se ndaj tij është ushtruar një trajtim diskriminues i përsëritur, i qëndrueshëm në kohë dhe i përshkallëzuar, i cili ka marrë forma të shumëfishta, duke përfshirë diskriminimin e drejtpërdrejtë, tërthortë, strukturor, shumëfishtë dhe viktimizimin. Ky diskriminim sipas tij është ushtruar për shkaqe të mbrojtura nga ligji përkatësisht gjendjes shëndetësore, statusit si person me aftësi të kufizuara dhe bindjeve politike/shprehjes së lirë të mendimit politik.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën SHRUKD.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesi parashtroi se, që prej qershorit 2016 është konstatuar si invalid i pjesshëm nga organet kompetente sipas ligjit nr.7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke ushtruar që atëherë detyrën me orar të reduktuar prej gjashtë orësh pune. Ankuesi thekson se gjatë gjithë kësaj periudhe marrëdhënia e punës ka qenë e qëndrueshme, pa asnjë masë disiplinore, vlerësim negativ apo konflikt me punëdhënësin, dhe se statusi i tij shëndetësor nuk ka shkaktuar asnjë pengesë në performancën e tij profesionale. Ankuesi pretendon se kjo situatë e stabilizuar ndryshoi rrënjësisht pas datës 04.05.2025, kur dha një intervistë publike për portalin “DurrësiLajm”.

Ai deklaroi se në intervistën e datës 04.05.2025, shprehu zhgënjimin e tij ndaj klasës politike shqiptare në përgjithësi, duke pretenduar se kjo deklaratë, e cila përbën ushtrim të së drejtës kushtetuese për lirinë e shprehjes sipas nenit 22 të Kushtetutës, nuk cenoi në asnjë mënyrë interesat e shoqërisë. Ankuesi pretendon se drejtuesit e shoqërisë e interpretuan intervistën si motiv për një seri veprimesh administrative hakmarrëse, duke vënë në dukje se për mbi njëzet e katër vite shërbimi të mëparshëm nuk ka ekzistuar asnjë problem i evidentuar, dhe se veprimet penalizuese filluan menjëherë pas kësaj interviste.

Me urdhrin nr. 194/5, datë 19.05.2025, shoqëria vendosi kalimin e tij nga pozicioni Inspektor pranë Njesisë Task Forcë në pozicionin Inspektor Grupi Operacional Nr.2 pranë Njesisë Operative Durrës, pa dakordësinë e tij me shkrim siç kërkohet nga neni 21 i Kodit të Punës. Ky veprim nuk u mbështetet në asnjë vlerësim të kapaciteteve punuese apo nevojë operative, por ishte reagim i drejtpërdrejtë ndaj shprehjes politike. Ky urdhër u shfuqizua me urdhrin nr. 72/1, datë 22.05.2025, pas paraqitjes së raportit mjekësor. Ankuesi pretendon se skenari u përsërit me urdhrin nr. 498, datë 05.11.2025, i cili parashikonte sërish kalimin e tij në pozicion tjetër pune dhe u revokua me Urdhrin nr. 498/1, datë 14.11.2025.

Sipas ankuesit, këto veprime përbëjnë diskriminim strukturor, pasi procedurat e brendshme të shoqërisë janë përdorur si mekanizma sistematike presioni, duke mohuar parimin e “akomodimit të arsyeshëm”, i cili imponon punëdhënësit të marrë masa pozitive për të parandaluar efektet negative mbi personat me aftësi të kufizuara.

Ankuesi pretendon se shoqëria refuzoi të njohë paraqitjen e tij fizike në punë gjatë muajit nëntor 2025 dhe zeroi pagën e tij të plotë mujore, pavarësisht deklaratës së tij zyrtare nr. 6151, datë 30.10.2025, për ndërprerjen e raportit mjekësor dhe rikthimin në punë, si dhe të dhënave të sistemit elektronik të regjistrimit të hyrje-daljeve. Sipas tij mospagimi i pagës për muajin nëntor është i pajustificueshëm edhe për shkak të konfuzionit administrativ të krijuar nga vetë shoqëria, pasi për periudhën 6-14 nëntor 2025, kur ai ishte formalisht i transferuar me urdhrin nr. 498, datë 05.11.2025 pranë Njesisë Operacionale Nr.2, shoqëria nuk mund ta penalizojë për mungesë nga listat e prezencës së Task Forcës.

Ai pretendon gjithashtu se punëdhënësi ka deklaruar pranë organeve tatimore një pagë fiktive prej 40.000 lekësh për këtë muaj, pa kryer asnjë transferim real në llogarinë e tij bankare, duke pretenduar shkelje të nenit 116 të Kodit të Punës, dhe se në asnjë moment nuk është ndjekur

procedura disiplinore e kërkuar nga neni 37 i Kodit të Punës. Sipas ankuesit, kjo përben diskriminim të drejtpërdrejtë (neni 3/4), viktimizim (neni 3/17) si hakmarrje për kundërshtimet administrative dhe shkelje të nenit 144 të Kodit të Punës për mungesa të pajustificuara.

Lidhur me pretendimin për diskriminim mbi bazën e bindjeve politike, ankuesi parashtroi se kronologjia e ngjarjeve dëshmon ekzistencën e një lidhjeje të qartë shkakësore ndërmjet intervistës publike të datës 04.05.2025 dhe fillimit të veprimeve administrative penalizuese. Ankuesi thekson se gjatë gjithë periudhës nëntëvjeçare që ai është vlerësuar si invalid i pjesshëm, marrëdhënia e punës ka qenë pa asnjë problem të evidentuar, dhe se veprimet e shoqërisë filluan menjëherë pas shprehjes publike të mendimit të tij politik.

Sipas pretendimeve të tij, sjellja e shoqërisë përmbush në mënyrë kumulative format e diskriminimit:

- Diskriminim i drejtpërdrejtë: Trajtim më pak favorizues i lidhur drejtpërdrejt me gjendjen shëndetësore dhe bindjet politike.
- Diskriminim i tërthortë: Masa neutrale në dukje (ndryshime pozicioni) që prodhojnë efekte disproporcionale pa justifikim.
- Diskriminim strukturor: Përdorim i procedurave institucionale për të mbështetur paragjykimet sistematike.
- Mohim i përshtatjes së arsyeshme: Mosaplikim i masave pozitive për akomodim.
- Diskriminim i shumëfishtë: Kombinim i shkaqeve (shëndet, aftësi e kufizuar, bindje politike).
- Viktimizim: Hakmarrje për kundërshtime administrative.

Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e të gjitha formave të diskriminimit si më sipër. Detyrimin e shoqërisë për të paguar pagën e muajit nëntor 2025, me të gjitha detyrimet financiare shoqëruese. Rikthimin e kushteve fillestare të punës, pa asnjë ndryshim arbitrar të pozicionit, funksionit apo pagës. Revokimin e çdo mase penalizuese të regjistruar në mënyrë të njëanshme. Vendosjen e gjobës administrative ndaj shoqërisë, sipas nenit 33 të ligjit. Dhënien e rekomandimeve detyruese për të parandaluar raste të ngjashme në të ardhmen. Publikimin e vendimit, për efekt edukues dhe parandalues. Dëmshpërblimin në formën e kompensimit të duhur pasuror dhe jo pasuror.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, ndërsa garanton në mënyrë të shprehur mbrojtje nga diskriminimi për shkak të *bindjeve politike, gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar*. Në

nenin 1 të LMD parashikohet se: ***“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”***

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në nenin 12, *“Ndalimi i diskriminimit”,* pika 1, germa “c”, të po këtij ligji, parashikohet: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në kuadër të shqyrtimit paraprak me *e-mailin* e datës 24.12.2025, ankuesit iu kërkua plotësimi i ankesës, sipas kërkesave të mëposhtme:
 - Vendosja në dispozicion të Komisionerit të materialit ku pretendohet se është bërë deklarata publike, mbi bazën e së cilës pretendohet diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe se si kjo deklaratë lidhet me punëdhënësin/shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.

- Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit aftësia e kufizuar, palës ankuese iu kërkua të depozitojë kopje të vendimit të KMCAP, i cili ka vlerësuar dhe vendosur për statusin si person me aftësi të kufizuara.

Me *e-mailin* datë 05.01.2026, ankuesi dërgoi informacion plotësues në lidhje me ankesën.

2. Me shkresën nr. 89 prot, datë 12.01.2026, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
3. Me shkresën nr. 218/2 prot., datë 23.01.2026, ka kthyer përgjigje Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a, duke parashtruar:

Z. V.Ç ka qenë punonjës i ish shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Durrës nga data 22/01/2001 deri në vitin 31/12/2022 me detyrë funksionale "Inspektor sektori", dhe në kuadrin e riorganizimit të sektorit të ujit, referuar, VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", shoqëria UKD sh.a ka transferuar aksionet e saj pranë shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime sh.a Durrës me NIPT M22031502M e cila është themeluar në datë 13/07/2022, nga data 01/01/2023 dhe aktualisht u bë transferimi si punonjës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizime Durrës me detyrë funksionale "Inspektor" pranë Drejtorisë Task Forcë.

Prej vitit 2016, nga momenti në të cilin z. Ç është konstatuar si invalid i pjesshëm nga organet kompetente, ka vazhduar të ushtrojë detyrat e tij funksionale me kohë të pjesshme (6 orë pune). Bazuar në përkushtimin, korrektesën dhe vjetërsinë në punë që ka pasur gjatë gjithë këtyre viteve, në vitin 2023 është vlerësuar me rritje në detyrë funksionale "Inspektor" pranë Drejtorisë Task Forcë. Kjo drejtori, aktualisht me ndryshimet në strukturën e re e quajtur Drejtoria e Ujit pa të Ardhura, mbulon fushën e kontroleve të vazhdueshme në terren me orë të plota dhe zona të shtrira nga qyteti i Rrogozhinës deri në Krujë.

Lidhur me ndryshimet e pozicionit të punës, shoqëria parashtron se, duke pasur parasysh fluksin e lartë të punës në Task Forcë dhe gjendjen shëndetësore të ankuesit, në prani të ish-titullarit të shoqërisë u diskutua dhe u ra dakord kthimi i tij në pozicionin e mëparshëm, gjë të cilën ankuesi e pranoi, me kusht që të ruante të njëjtën pagë, kërkesë kjo e pamundur për t'u plotësuar për shkak të strukturës së kategorizuar të pagave. Shoqëria parashtron se ndryshimi i pozicionit u zbatua me Urdhrin nr. 194/5, datë 19.05.2025, i cili u shfuqizua me urdhrin nr. 72/1, datë 22.05.2025, pasi ankuesi paraqiti raport mjekësor. Nga data 19.05.2025 deri më 30.10.2025 ankuesi vijoi me raporte mjekësore të vazhdueshme. Pas deklaratës së ankuesit të datës 30.10.2025 për rikthim në punë, shoqëria nxori Urdhrin nr. 498, datë 05.11.2025, për ndryshimin e pozicionit, i cili u revokua gjithashtu pas paraqitjes së një raporti mjekësor të ri për periudhën 30.10.2025–14.11.2025.

Lidhur me situatën e raporteve mjekësore, shoqëria parashtron se konfuzioni i krijuar lidhet me faktin se ankuesi, ndërkohë që ndodhej me raport mjekësor për periudhën 30.09.2025–30.10.2025, paraqiti më datë 30.10.2025 deklaratën nr. 6151 me të cilën kërkoi ndërprerjen e pagesës së raportit,

duke deklaruar se kishte qenë në punë që prej datës 01.10.2025, duke krijuar mospërputhje faktike dhe ligjore mbi statusin e tij real. Në të njëjtën datë, në sistemin *e-Albania* të shoqërisë u depozitua nga Spitali Rajonal Durrës raporti mjekësor nr. 504 për periudhën 30.10.2025–14.11.2025. Në këto rrethana, shoqëria parashtroi se me shkresën nr. 6497, datë 17.11.2025, kërkoi sqarim zyrtar nga Spitali Rajonal Durrës dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës. Në vijim, me shkresën nr.6497/1, datë 02.12.2025, Spitali Rajonal Durrës konfirmoi se raporti për periudhën 30.09.2025–30.10.2025 ishte anuluar, ndërsa me shkresën nr.6497/2, datë 09.12.2025, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore konfirmoi se raporti për periudhën 30.10.2025–14.11.2025 ishte i pavlefshëm dhe kishte humbur çdo efekt juridik.

Lidhur me mospagimin e pagës për muajin nëntor 2025, shoqëria parashtroi se nga verifikimi i listë prezencës dhe i regjistrave elektronikë të hyrje-daljeve rezultoi se ankuesi nuk është paraqitur në vendin e punës për periudhën 03.11.2025–25.11.2025. Shoqëria thekson se regjistrimi elektronik i *check-in/check-out* i kryer nga ankuesi për datat 17–26 nëntor 2025 nuk provohet prani faktike në detyrë, pasi edhe këto ditë orari i reduktuar prej gjashtë orësh nuk është plotësuar, ndërsa mos prezenca faktike vërtetohet nga urdhrat e punës dhe procesverbalet e grupeve të Njësisë Task Forcë, të cilat ankuesi nuk i ka firmosur. Shoqëria parashtroi se në mungesë të raportit mjekësor të vlefshëm dhe të paraqitjes faktike në punë, paga për muajin nëntor 2025 është përlogaritur në vlerën 5.885 lekë bruto, duke përfshirë vetëm pagesën e raportit mjekësor të vlefshëm për datat 26–30 nëntor 2025, në përputhje me nenet 110, 116 dhe 119 të Kodit të Punës. Shoqëria sqaron gjithashtu se deklarimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi pagën minimale prej 40.000 lekësh nuk përbën deklarim fiktiv. Deklarimi është kryer në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, ligjit nr. 9920 si dhe të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015, i ndryshuar. Është kryer deklarimi elektronik i detyrueshëm i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përmes formularit E-SIG 02, brenda afatit ligjor, duke respektuar detyrimin për deklarimin e kontributeve mbi pagën minimale në fuqi 40.000 lekë, nëpërmjet sistemit *e-Filing*, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe rregulloreve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shoqëria parashtroi se ankuesi vazhdon të ushtrojë marrëdhënien e punës në pozicionin Inspektor Verifikim Kontrolli, në Drejtorinë e Ujit pa të Ardhurave dhe nuk është kryer kalimi në detyrën Inspektor Grupi, të cilën e ka ushtruar për një periudhë më të gjatë se njëzet (20) vjet, pavarësisht se volumi i punës në këto grupe është më i ulët, punonjësi e konsideron këtë ndryshim si ulje në detyrë. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, mohon kategorikisht ekzistencën e çdo forme diskriminimi ndaj ankuesit dhe parashtroi se të gjitha veprimet e ndërmarra kanë qenë në përputhje me ligjin dhe në funksion të mbështetjes së punonjësit.

4. Ankuesi ka depozituar prapësimet e tij në lidhje me qëndrimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, të cilat janë administruar pranë Komisionerit me nr. 89/3 prot., datë 12.02.2026.

Ankuesi, në prapësimet e tij ndaj qëndrimit të SHRUKD-së, parashtroi se çështja në shqyrtim nuk përbën një konflikt të zakonshëm administrativ apo një seri keqkuptimesh procedurale të izoluar,

por një varg veprimesh të ndërgjegjshme, të ndërlidhura në kohë, objekt dhe qëllim, të cilat, të analizuara në tërësi, përbëjnë një model të strukturuar të sjelljes represive ndaj një punonjësi për shkak të bindjeve të tij politike dhe gjendjes shëndetësore.

Ai kundërshton pretendimin e shoqërisë se ndryshimi i pozicionit të punës është kryer me dakordësinë e tij, duke argumentuar se Urdhri nr.194/5, datë 19.05.2025 është nxjerrë pikërisht në datën kur ai ka hyrë në regjim mjekësor, moment në të cilin ndodhej në kushte vulnerabiliteti shëndetësor dhe nuk kishte mundësi reale të shprehë vullnet të lirë dhe të informuar. Ankuesi thekson gjithashtu se komunikimi i vendimit u krye nëpërmjet aplikacionit "*WhatsApp*" në prag të një ndërhyrjeje kirurgjikale, dhe se pozicioni i propozuar operativ terreni, me ngarkesë fizike më të lartë, nuk mund të konsiderohet masë lehtësuese për një person me diagnozë neurologjike dhe probleme të dokumentuara në shtyllën kurrizore.

Lidhur me mospagimin e pagës për muajin nëntor 2025, ankuesi argumenton se shoqëria nuk mund ta konsiderojë të munguar nga listat e prezencës së Task Forcës për periudhën 6-14 nëntor 2025, pasi me urdhrin nr.498, datë 05.11.2025, ai ishte transferuar zyrtarisht pranë Njesisë Operacionale Nr.2, dhe se vetëm me shkresën e datës 17.12.2025 administrata e ka njoftuar për rikthimin në Task Forcë. Ankuesi pretendon gjithashtu se rikthimi i tij i hershëm nga raporti mjekësor nuk ka qenë shenjë e përmirësimit shëndetësor, por akt vetëmbrojtjeje institucionale nga frika e veprimeve të mëtejshme penalizuese gjatë mungesës së tij.

Në përfundim, ankuesi parashtron se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë shkakësore ndërmjet intervistës publike të datës 04.05.2025 dhe fillimit të veprimeve administrative penalizuese, duke theksuar se mbi njëzet e katër vite shërbim të mëparshëm kanë kaluar pa asnjë problem, dhe se veprimet e shoqërisë përbëjnë shkelje të neneve 18, 22 dhe 49 të Kushtetutës, të nenit 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të ligjit nr.10221/2010, në mbështetje të jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen *Vogt kundër Gjermanisë*.

5. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet: "*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar*", për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore në datën 03.04.2026. Seanca dëgjimore iu komunikua palëve me shkresën nr.540 prot., datë 12.03.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e të dy palëve, ankuesit V.Ç , i cili u paraqit së bashku me përfaqësuesin e tij Av.D.B, me nr.license nr.10483 dhe SHRUKD, përfaqësuar nga R.P, me detyrë Shefe Kabineti dhe F.K , me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, sipas autorizimit nr.1982 prot., datë 02.04.2026.

6. Në vijim të seancës dëgjimore me *e-mail* datë 26.04.2026, ankuesi depozitoi prova të reja në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike. Ndër të tjera ankuesi parashtron se, ndryshimi i qëndrimit të punëdhënësit ndaj tij pas 25 vitesh pune, pa asnjë masë disiplinore përkon drejtpërdrejtë me intervistën e tij politike të datës 04.05.2025. Ai pretendon

se provat e depozituara vërtetojnë se drejtuesit e shoqërisë janë protagonistë të aktiviteteve partiake.

Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi paraqiti prova fotografike nga profile publike në rrjete sociale duke pretenduar pjesëmarrjen e Administratorit të SHRUKD, z. O.K dhe Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore, znj. F.K , në aktivitete të Partisë Socialiste. Ai pretendon gjithashtu se mungesa e çdo portali zyrtar për shpalljen e vendeve të punës dëshmon punësime të mbyllura dhe politikisht të kontrolluara. Të gjitha këto, sipas tij, bashkë me transferimet arbitrare, aktet kontradiktore dhe penalizimet ekonomike, përbëjnë një strategji të qëllimshme viktimizimi për shkak të bindjeve të tij politike.

Sa më sipër u depozitua nga ankuesi, iu vendos në dispozicion SHRUKD, nëpërmjet *e-mailit* datë 21.05.2026. SHRUKD, nuk depozitoi parashtrime në lidhje me sa iu komunikua.

7. Me shkresën nr.2743 prot., datë 12.05.2026, me lëndë “*Vënie në dijeni mbi mospranimin e pozicionit të propozuar nga z.V.Ç*”, SHRUKD, informoi ndër të tjera:

Në vijim të seancës dëgjimore të datës 03.04.2026, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për punëmarrësin z.V.Ç , shoqëria ka ndërmarrë hapat përkatës për sistemimin e tij në një pozicion alternativ pune, në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore dhe aftësinë për ushtrimin e detyrës. Në këtë kuadër, punëdhënësi i ka propozuar z. V.Ç pozicionin “Inspektor Gr.Nr.1/Spektori Menaxhim Debie në Njësinë Operative Durrës, pozicion i cili do të jetë në të njëjtin nivel page me pozicionin aktual. Z.V.Ç është njohur me propozimin e bërë nga punëdhënësi, por ka shprehur mos dakordësinë dhe nuk e ka pranuar pozicionin e propozuar. Pavarësisht gatishmërisë së shoqërisë për të ofruar një alternativë pune të përshtatshme dhe pa ndryshim në nivelin e pagës, punëmarrësi nuk ka dhënë pëlqimin për sistemimin në këtë pozicion duke vijuar të bëhet pengesë për vijimin normal të punës.

8. Me *e-mailin* e datës 21.05.2026, SHRUKD, informoi Komisionerin se, bazuar në kërkesën e ankuesit për t’u larguar nga puna për shkak të daljes në Kemp, shoqëria ka vendosur të zgjidhë kontratën e punës me ankuesin.
9. Informacioni i mësipërm i depozituar nga SHRUKD, i është vendosur në dispozicion ankuesit nëpërmjet *e-mailit* datë 21.05.2026. Nëpërmjet *e-mailit* datë 29.06.2026, ankuesi depozitoi prapësimet e tij.

Ankuesi kundërshton pretendimin e SHRUKD, se ai ka qenë pengesë për ecurinë normale të punës, duke sqaruar se oferta për pozicion alternativ me të njëjtën pagë nuk ishte akt bashkëpunimi, por u kushtëzua me tërheqjen e ankesës për diskriminim, një shantazh administrativ që ai e refuzoi si akt mbrojtjeje të drejtave të tij. Ankuesi pretendon se ky kushtëzim, i shoqëruar me përkeqësimin e gjendjes shëndetësore dhe largimin e detyruar nga puna për pension invaliditeti, dëshmon jo vetëm vazhdimësinë e trajtimit diskriminues, por edhe pranimin e tërthortë të fajësisë nga ana e punëdhënësit, duke kërkuar nga Komisioneri që shkresa e SHRUKD të trajtohet si provë e

viktimizimit dhe çështja të zgjidhet me vendim merite, duke konstatuar diskriminimin e shumëfishtë dhe strukturor të ushtruar nga kjo shoqëri.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm

Faktet dhe rrethanat

Bazuar në faktet, rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se ankuesi V.Ç ka qenë në marrëdhënie pune pranë SHRUKD, me detyrë “Inspektor| Verifikim Kontroll, pranë Sektorit të Kontrollit dhe Verifikimit, në Drejtorinë e Ujit pa të Ardhura, Njësia Task Forcë, marrëdhënie e rregulluar mbi bazën e kontratës së punës të lidhur në datë 01.01.2023.

Rezultoi se ankuesi kishte qenë në marrëdhënie pune që prej datës 22.01.2001, duke ushtruar detyrën funksionale “Inspektor sektori” pranë ish-shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a (UKD sh.a) deri më 31.12.2022. Në kuadër të riorganizimit të sektorit të ujit, referuar VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, shoqëria UKD sh.a. transferoi aksionet e saj pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a. (NIPT M22031502M, themeluar më 13.07.2022), ku ankuesi u transferua nga data 01.01.2023 me detyrë funksionale "Inspektor" pranë Njesisë Task Forcë. Sipas shoqërisë, në vitin 2023 ankuesi u vlerësua me rritje në detyrë, nga "Inspektor Sektori" në "Inspektor" pranë kësaj njësie, bazuar në përkushtimin dhe vjetërsinë e tij në punë.

Bazuar në aktet e administruara rezulton e provuar se ankuesi me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, gëzon statusin si invalid pune i pjesshëm Gr.4, i cili është vlerësuar se duhet të punojë me ngarkesë pune $\frac{3}{4}$ e normës ditore të punës. Konfirmohet dhe pranohet nga të dy palët se, prej vitit 2016, nga momenti në të cilin ankuesi është konstatuar si invalid i pjesshëm nga organet kompetente, ka vazhduar të ushtrojë detyrat e tij funksionale me kohë të pjesshme, 6 orë pune. Sipas dokumentacionit mjekësor të administruar rezulton se ankuesi vuan nga “*Parapareza inferiore post-op për DH-lumbare recidivante*” operuar 3 here, dhe sipas flete drejtimit per KMCAP të datës 05.12.2025 me nr.karte 1320, të Spitalit Rajonal Durrës, ankuesi është referuar për KMCAP për aftësi të plotë për punë.

- Ndryshimi i parë i pozicionit të punës (maj 2025)

Me vendimin nr. 194/5 prot., datë 19.05.2025, SHRUKD vendosi që, duke filluar nga data 21.05.2025, ankuesi të kalonte nga detyra “Inspektor” pranë Njesisë Task Forcë në detyrën “Inspektor Grupi Operacional Nr. 2 pranë Skuadrës Operacionale Nr. 2 të Njesisë Operative

Durrës". Shoqëria shpjegoi se Drejtoria e Ujit pa të Ardhura mbulon kontrolle të vazhdueshme në terren, me orar të plotë dhe në një territor të shtrirë nga Rrogozhina deri në Krujë, dhe se, për shkak të fluksit të lartë të punës dhe të gjendjes shëndetësore të ankuesit, u diskutua në praninë e ish-administratorit, z. Sedi Çausi, kthimi i tij në pozicionin e mbajtur para vitit 2023, gjë që sipas shoqërisë u pranua nga ankuesi, me kërkesën për ruajtjen e së njëjtës pagë, por për shoqërinë kjo ishte e pamundur. Në datën 20.05.2025, Qendra Shëndetësore Nr. 2 Durrës lëshoi për ankuesin raport mjekësor për periudhën 19.05.2025-24.05.2025. Në vijim, me vendimin nr. 72/1, datë 22.05.2025, SHRUKD vendosi që kalimi në pozicionin e ri të kryhej pas përfundimit të raportit mjekësor. Nuk rezultoi nga aktet që ankuesi të kishte paraqitur ndonjë ankesë a kundërshtim pranë punëdhënësit lidhur me këtë urdhër.

Ankuesi vijoi më pas me një sërë raportesh mjekësore të njëpasnjëshme: 24.05.2025-02.06.2025 (QSH Nr. 2 Durrës); 02.06.2025-01.08.2025 (Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"); 01.08.2025-31.08.2025 dhe 31.08.2025-30.09.2025 (të dyja nga Spitali Rajonal Durrës); si dhe 30.09.2025-30.10.2025 (raport i lëshuar më 30.09.2025 nga Spitali Rajonal Durrës).

- Deklarata e 30.10.2025 dhe pagesa e muajit tetor 2025

Ndërkohë që ishte formalisht me raport mjekësor, ankuesi iu drejtua punëdhënësit me shkresën nr. 6151 prot., datë 30.10.2025, duke deklaruar se kishte punuar faktikisht nga 30.09.2025 deri më 30.10.2025 dhe duke kërkuar që kjo periudhë të mos i paguhej si raport nga sigurimet shoqërore. Sipas listëprezencës së muajit tetor 2025, të mbajtur për Njësinë Task Forcë, ankuesi u deklarua prezent nga drejtuesi i njësisë, dhe mbi këtë bazë punëdhënësi kreu pagesën e plotë për muajin tetor 2025.

- Ndryshimi i dytë i pozicionit të punës (nëntor 2025) dhe kundërshtimet e paraqitura nga ankuesi

Me vendimin nr. 498, datë 05.11.2025, SHRUKD urdhëroi që, nga data 06.11.2025, ankuesi të kalonte nga "Inspektor në Njësinë Task Forcë" në "Inspektor në Njësinë Operacionale (Skuadra Operacionale Nr. 2 pranë Njësisë Operative Durrës)". Pasi mori dijeni për këtë vendim, ankuesi paraqiti ankesë më 10.11.2025. Ndërkohë, më 28.10.2025, Spitali Rajonal Durrës kishte lëshuar për ankuesin një raport të ri mjekësor për periudhën 30.10.2025-15.11.2025. Bazuar në këtë raport, punëdhënësi, me vendimin nr. 498/1, datë 14.11.2025, revokoi urdhrin e datës 05.11.2025, deri në rikthimin e ankuesit në punë pas përfundimit të raportit mjekësor nga sigurimet shoqërore.

Me shkresën nr. 6355/1 prot., datë 19.11.2025, SHRUKD iu përgjigj ankesës së datës 10.11.2025, duke parashtruar se ndryshimi i detyrës ishte kryer me dakordësinë e ankuesit, në praninë e ish-titullarit të shoqërisë, se ndryshimi ishte zbatuar fillimisht me urdhrin e 19.05.2025 e më pas shfuqizuar me urdhrin e datës 22.05.2025 (për shkak të raportit mjekësor), dhe se, pas rikthimit në punë, ishte nxjerrë urdhri i datës 05.11.2025, i revokuar më pas pas paraqitjes së raportit mjekësor për periudhën 30.10.2025-15.11.2025. Shoqëria informoi ankuesin se i ishte drejtuar Spitalit Rajonal Durrës dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës për sqarimin e

vlefshmërisë së raportit, dhe theksoi se ndryshimi i pozicionit ishte rrjedhojë e ngarkesës së punës dhe e gjendjes shëndetësore, me qëllim lehtësimin e kushteve të punës e jo penalizimin e ankuesit.

Ankuesi depozitoi më 21.11.2025 kundërshtimin e tij ligjor ndaj shkresës nr. 6355/1 prot., datë 19.11.2025, duke pretenduar shkelje të dispozitave të Kodit të Punës dhe të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Sipas ankuesit, pretendimi i shoqërisë për dakordësi verbale, të shprehur në prani të ish-titullarit, nuk gjen mbështetje në nenin 21 të Kodit të Punës, pasi deklaratat verbale apo prezencat fizike nuk zëvendësojnë kërkesën ligjore për pëlqim me shkrim; në mungesë të një akti të shkruar që konfirmon ndryshimin e kushteve thelbësore të punës (pozicioni, përshkrimi i detyrave, paga), çdo ndryshim i tillë është i paligjshëm. Lidhur me pretendimin e punëdhënësit se ndryshimi synonte lehtësimin e kushteve për shkak të gjendjes shëndetësore, ankuesi parashtrroi se punëdhënësi ka detyrimin ligjor për përshtatje të arsyeshme dhe se, nëse ndryshimi i pozicionit sjell ulje page apo statusi profesional, ky veprim nuk përbën "lehtësim" apo "përshtatje të arsyeshme", por penalizim ekonomik të drejtpërdrejtë, çka bie ndesh me parimet e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mund të përbëjë diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për shkak të gjendjes shëndetësore/aftësisë së kufizuar. Ankuesi kërkoi revokimin e të gjitha veprimeve që sollën ndryshimin e njëanshëm të pozicionit dhe uljen e pagës, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm.

Me shkresën nr. 6355/3 prot., datë 17.12.2025, në vijim të ankesës së 21.11.2025, shoqëria informoi ankuesin se vendimi për kalimin e tij në pozicion tjetër ishte revokuar dhe se ai duhej të paraqitej rregullisht në detyrë pranë Njesisë Task Forcë.

- Çështja e mungesave dhe mospagesa për muajin nëntor 2025

Meqenëse ankuesi kishte deklaruar (shkresa nr. 6151 prot., datë 30.10.2025) se kishte punuar gjatë një periudhe të mbuluar me raport mjekësor, dhe në kushtet kur ishte lëshuar edhe raporti për periudhën 30.10.2025–14.11.2025, shoqëria, me shkresën nr. 6497 prot., datë 17.11.2025, kërkoi sqarim nga Spitali Rajonal Durrës mbi statusin mjekësor të ankuesit dhe vlefshmërinë e raporteve, si dhe informacion nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës. Me shkresën nr. 19027/1 prot., datë 04.12.2025, Spitali Rajonal Durrës informoi SHRUKD se raporti për periudhën 30.09.2025–30.10.2025 ishte i pavlefshëm dhe i anuluar në sistemin e-RM. Rezultoi gjithashtu se edhe raporti për periudhën 30.10.2025–14.11.2025 u konsiderua i pavlefshëm. Për periudhën 26.11.2025–10.12.2025, ankuesi u pajis me raport të ri, të vlefshëm, lëshuar nga QSH Nr. 2 Durrës.

Sipas regjistrimeve elektronike (check-in/check-out) të depozituara nga SHRUKD, ankuesi ka kryer regjistrim ditor vetëm për datat 17, 18, 19, 20, 21, 25 dhe 26 nëntor 2025, pa plotësuar orarin prej 6 orësh pune sipas regjimit të reduktuar, ndërsa për periudhën 03.11.2025–14.11.2025 (me përjashtim të ditëve 01–02, pushim) nuk rezultoi asnjë regjistrim. Kjo u mbështet edhe nga urdhrat e punës dhe procesverbalet e grupeve të punës të Task Forcës, ku ankuesi nuk figuronte i përfshirë e as i firmosur. Sipas listëprezencës së nëntorit 2025 për Njësinë Task Forcë, ankuesi u pasqyrua

me mungesë në punë për periudhën 03.11.2025–25.11.2025 dhe me raport mjekësor për datat 26–27.11.2025.

Me shkresën e datës 24.12.2025, ankuesi i kërkoi shoqërisë shlyerjen e pagës së papaguar për muajin nëntor 2025, duke pretenduar se ishte paraqitur rregullisht në punë në të gjitha ditët pa raport mjekësor, dhe se punëdhënësi kishte deklaruar pranë organeve tatimore një pagë fiktive prej 40.000 lekësh (mbi të cilën ishin paguar kontributet) ndërsa as kjo shumë e as paga bazë prej 80.000 lekësh nuk i ishin transferuar në llogari, duke pretenduar kështu shkelje të pagesës së rregullt, zbritje të plotë të pagës pa procedurë disiplinore, deklarim të pagës fiktive për efekt kontributesh, si dhe shkelje të parimit të ndalimit të diskriminimit.

Nga tërësia e akteve rezultoi se, për periudhën 03–05.11.2025, ankuesi ishte ende zyrtarisht me detyrë pranë Njesisë Task Forcë (pasi urdhri i kalimit hyri në fuqi më 06.11.2025) dhe nuk rezultoi i paraqitur në detyrë. Për periudhën 06–14.11.2025 ai duhej të paraqitej pranë Njesisë Operacionale Nr. 2, çka nuk rezultoi e provuar sipas regjistrimit elektronik, ndërsa, pas revokimit të urdhrit më 14.11.2025, ankuesi duhej të figuronte sërish pranë Task Forcës. Në këto kushte, pretendimi i ankuesit se procesverbalet dhe urdhrat e punës të Task Forcës nuk provojnë mungesën e tij (me arsyetimin se, sipas urdhrave në fuqi, ai duhej të ishte në njësinë tjetër) vlerësohet i pabazuar, si për periudhën 03–05.11.2025 ashtu edhe për periudhën pas datës 14.11.2025.

Me shkresën nr. 5 prot., datë 05.01.2026, SHRUKD iu përgjigj kërkesës së ankuesit të datës 24.12.2025, duke sqaruar se ai nuk ishte paraqitur në punë nga 03.11.2025 deri më 25.11.2025, se për periudhën 26.11.2025–10.12.2025 ishte i pajisur me raport të vlefshëm, dhe se, në kushtet e pavlefshmërisë së raporteve të mëparshme, mospagimi i pagës për periudhën e mungesave të pajustificuara ishte i ligjshëm.

- Përfundimi i marrëdhënies së punës

Ankuesi vijoi punën pranë Njesisë Task Forcë deri më 20.05.2026, kur marrëdhënia e tij e punës u zgjidh, sipas kërkesës së tij, me vendimin nr. 271, datë 18.05.2026. Me vendimin nr. 271/1, datë 19.05.2026, punëdhënësi saktësoi se zgjidhja e marrëdhënies së punës ishte bërë me kërkesën e ankuesit për shkak të daljes në KEMP.

Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi kundër punëdhënësit/SHRUKD duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar dhe bindjeve politike.

Vlerësimi i Komisionerit

Konfirmohet dhe pranohet nga të dyja palët se ankuesi gëzon statusin e invalidit të pjesshëm gr.4 që prej vitit 2016, i vlerësuar me ngarkesë pune $\frac{3}{4}$ e normës ditore, duke ushtruar që atëherë detyrën me orar të reduktuar prej 6 (gjashtë) orësh. Rezulton gjithashtu e provuar nga dokumentacioni mjekësor i administruar se ankuesi vuan nga "*Parapareza inferiore post-op për DH-lumbare recidivante*", operuar tre herë.

Në referim të nenit 1, të LMD-së, “*gjendja shëndetësore*” dhe “*aftësia e kufizuar*” përbëjnë shkaqe të mbrojtura nga diskriminimi dhe provohet plotësisht se ankuesi i mbart të dy këto shkaqe.

Në rrethanat e çështjes konkrete, rezulton se statusi i ankuesit si person me aftësi të kufizuara është drejtpërdrejt i rrjedhur dhe i kushtëzuar nga gjendja e tij shëndetësore, konkretisht nga diagnoza e tij mjekësore. Vlerësimi i KMCAP për statusin e invalidit të pjesshëm gr.4 nuk është një fakt i pavarur nga gjendja shëndetësore, por pasojë e drejtpërdrejtë e saj. Prandaj, në rrethanat e kësaj çështjeje, gjendja shëndetësore dhe aftësia e kufizuara, nuk funksionojnë si dy shkaqe të pavarura dhe të dallueshme, por si një shkak i vetëm i shprehur në dy dimensione, dimensionin mjekësor, i cili përshkruan natyrën e gjendjes shëndetësore dhe dimensionin juridik-administrativ, i cili pasqyron njohjen zyrtare të kufizimeve që rrjedhin prej saj.

Ankuesi nuk pretendon diskriminim veçmas për shkak të aftësisë së kufizuar dhe veçmas për shkak të bindjeve politike, por pretendon se këto dy shkaqe kanë ndërvepruar midis tyre. Konkretisht, ankuesi argumenton se gjendja e tij shëndetësore dhe aftësia e kufizuar kanë ekzistuar që prej vitit 2016 pa shkaktuar asnjë problem gjatë gjithë kësaj periudhe. Gjithashtu, rezulton se, punëdhënësi/SHRUKD e ka vlerësuar me rritje në detyrë funksionale pranë Drejtorisë Task Forcë në vitin 2023.

Ankuesi argumenton se vetëm pas intervistës publike të datës 04.05.2025, ku ankuesi deklaroi zhgënjim "ndaj klasës politike shqiptare në përgjithësi" punëdhënësi filloi të përdorë gjendjen shëndetësore dhe aftësinë e kufizuar si pretekst dhe instrument për të justifikuar veprime administrative të motivuara në realitet nga bindjet politike. Ankuesi nuk pretendon se deklarata e tij publike ishte ndaj shoqërisë apo drejtuesve të saj specifikisht, por pretendon se kjo deklaratë nuk është mirëpritur nga drejtuesit e shoqërisë, të cilët sipas tij janë të përfshirë në aktivitete politike të subjektit politik Partia Socialiste.

Sipas logjikës së pretendimit të ankuesit, aftësia e kufizuar nuk do të kishte shërbyer si pretekst për ndryshimet e pozicionit të punës po të mos kishte ndodhur intervista politike, ndërkohë që intervista politike vetëm nuk do të kishte prodhuar këtë efekt specifik po të mos ekzistonte gjendja shëndetësore dhe aftësia e kufizuar, si mjet për ta justifikuar formalisht ndryshimin.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për ndryshimin e pozicionit të punës

Komisioneri konstaton se urdhri nr.194/5, datë 19.05.2025, parashikoi kalimin e ankuesit nga pozicioni Inspektor pranë Njesisë Task Forcë në pozicionin Inspektor Grupi Operacional Nr.2 pranë Njesisë Operative Durrës. Ky urdhër u miratua pa një vlerësim mjekësor paraprak dhe pa dakordësinë me shkrim të ankuesit, siç kërkohet nga neni 21 i Kodit të Punës, ku parashikohet: “*1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.*” Urdhri për ndryshimin e pozicionit të punës, u shfuqizua me urdhrin nr.72/1, datë 22.05.2025, pas paraqitjes së raportit mjekësor, ndërkohë që me urdhrin nr.72/1, datë 22.05.2025, u parashikua kalimi i ankuesit në pozicionin e ri pas përfundimit të raportit mjekësor.

Konstatohet se, urdhri nr.194/5, datë 19.05.2025, është nxjerrë nga punëdhënësi kur ky i fundit nuk ka pasur dijeni për raportin mjekësor të ankuesit, pasi raporti pavarësisht se përfshin datën 19.05.2025, është nxjerrë nga institucioni shëndetësor në datën 20.05.2025. Menjëherë pasi punëdhënësi ka marrë dijeni për faktin se ankuesi ka qenë me raport mjekësor ai ka marrë masa për të shfuqizuar urdhrin për ndryshimin e pozicionit të punës. Skenari i ndryshimit të pozicionit të punës u përsërit me urdhrin nr.498, datë 05.11.2025, pasi ankuesi paraqiti deklaratën e datën 30.10.2025, nëpërmjet të cilës deklaronte se ishte rikthyer në punë dhe nuk donte që t'i paguhej raporti mjekësor nga sigurimet shoqërore, i cili u revokua me urdhrin nr.498/1, datë 14.11.2025, pas paraqitjes së raportit të ri mjekësor.

Fakti se shoqëria vetë e ka vlerësuar ankuesin me rritje në detyrë funksionale pranë Drejtorisë Task Forcë në vitin 2023, pikërisht kur statusi i tij si person me aftësi të kufizuara ishte tashmë i konsoliduar dhe i njohur zyrtarisht, dëshmon se aftësia e kufizuara në vetvete nuk ka shërbyer si faktor penalizues gjatë kësaj periudhe.

Urdhri për ndryshimin e pozicionit të punës i datës 19.05.2025, u shfuqizua brenda tri ditësh pa prodhuar efekte të qëndrueshme në statusin profesional apo pagën e ankuesit. Gjithashtu, vetë ankuesi, nuk e kundërshtoi ndryshimin gjatë gjithë periudhës maj - tetor 2025, gjë që tregon se nuk e perceptoi atë si trajtim të pafavorshëm në momentin e ndodhjes. Shoqëria, pas seancës dëgjimore, propozoi pozicion alternativ me të njëjtin nivel page, duke dëshmuar vullnet për të shmangur çdo efekt negativ.

Bazuar në kronologjinë e fakteve dhe rrethanave, Komisioneri konstaton se zinxhiri shkakësor i pretenduar nga ankuesi nuk rezulton i mbështetur në provat e administruara. Rezulton se, administratori i shoqërisë në periudhën maj 2025, kur pretendohet se filloi trajtimi diskriminues si reagim ndaj intervistës publike, ka qenë z.Sedi Çausi dhe jo z.O.K , i cili identifikohet nga ankuesi se është i ekspozuar politikisht. Në këto kushte, kur z. O.K , administratori aktual i SHRUKD, nuk ka qenë vendimmarrësi në momentin e parë të ndryshimit të pozicionit të punës në muajin maj 2025, pretendimi se aftësia e kufizuara u përdor si mjet i motivimit të tij politik, nuk gjen mbështetje. Intervista e datës 04.05.2025 nuk përmban asnjë deklaratë specifike kundër drejtuesve të shoqërisë apo interesave të saj. Heshtja e ankuesit gjatë gjithë periudhës maj -tetor 2025, pa paraqitur asnjë kundërshtim ndaj urdhrin të datës 19.05.2025 nuk mbështet pretendimin se ai vetë e ka perceptuar ndryshimin e pozicionit si ndëshkim të motivuar politikisht në momentin e ndodhjes.

Sa i takon pretendimit për viktimizim në lidhje me ndryshimet e pozicionit të punës, Komisioneri i referohet nenit 3, pika 17, të LMD, sipas të cilit: “ 17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.”

Ndryshimi i parë i pozicionit të punës, konkretisht urdhri nr.194/5, datë 19.05.2025 dhe më pas urdhri nr.72/1, datë 22.05.2025, i paraprijnë çdo kundërshtimi të ankuesit, i cili ngriti pretendime

me shkrim dhe kundërshtoi ndryshimin e pozicionit të punës, duke pretenduar se një gjë e tillë ishte edhe diskriminuese, për herë të parë me shkresën e datës 10.11.2025, pas nxjerrjes së urdhrit nr.498, datë 05.11.2025.

Në këto kushte, pretendimi për viktimizim në lidhje me ndryshimet e pozicionit të punës, është haptazi i pabazuar, pasi neni 3, pika 17, e LMD kërkon që trajtimi i disfavorshëm, në këtë rast ndryshimi i pozicionit të punës, të jetë pasojë dhe të vijë më pas në kohë, të ushtrimit të të drejtës për të paraqitur një ankim për diskriminim, pra të jetë reagim ndaj tij dhe jo t'i paraprijë ankimit për diskriminim. Ankuesi nuk kishte paraqitur ankesë për diskriminim para nëntorit 2025 dhe në këto kushte pretendimi për viktimizim sipas neni 3, pika 17, të LMD, nuk është i bazuar.

Komisioneri evidenton se, pavarësisht nga veprimet administrative të pretenduara si diskriminuese, ankuesi ka vijuar marrëdhënien e punës pranë SHRUKD në pozicionin Inspektor pranë Njësisë Task Forcë deri në datën 20.05.2026, pa ndërprerje dhe pa u ekspozuar ndaj ndonjë mase largimi apo ndëshkimi gjatë gjithë kësaj periudhe. Marrëdhënia e punës ka përfunduar me kërkesën e vetë ankuesit, si pasojë e daljes në KEMP dhe jo si rezultat i ndonjë veprimi të punëdhënësit. Pretendimi i ankuesit i depozituar nëpërmjet *e-malit* datë 29.06.2026, se propozimi i shoqërisë për një pozicion tjetër pune pa ndryshime në pagë u kushtëzua me tërheqjen e ankesës për diskriminim, një shantazh administrativ që ai e refuzoi si akt mbrojtjeje të drejtave të tij, nuk rezultoi i provuar nga provat e administruara. Në kërkesën për shpëputjen e marrëdhënieve të punës që ankuesi ka depozituar pranë punëdhënësit në datën 18.05.2026, ankuesi nuk e pretendon një fakt të tillë. Në mungesë të provave, pretendimi i ankuesit mbetet në nivelin e deklaratës së njëanshme dhe nuk arrin të kalojë prapë në kërkuar për të transferuar barrën e provës te shoqëria.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, Komisioneri konstaton se punëdhënësi nuk rezultoi të ketë ndërmarrë masa që kishin si qëllim apo pasojë përfundimin e detyruar të marrëdhënies së punës të ankuesit, duke forcuar kështu konkluzionin e Komisionerit se veprimet e SHRUKD-së nuk kanë qenë të motivuara nga shkaqe diskriminuese dhe nuk kanë prodhuar efekte të qëndrueshme negative në pozitën profesionale dhe ekonomike të ankuesit.

Për sa më sipër, mungesa e dakordësisë me shkrim, duket si pasojë e keqadministrit procedural dhe jo e motivuar nga shkaqet e diskriminimit. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e punëdhënësit/SHRUKD.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për mohim të përshtatjes së arsyeshme

Ankuesi pretendon se punëdhënësi ka mohuar përshtatjen e arsyeshme, duke argumentuar se SHRUKD nuk ka marrë masa pozitive për të parandaluar efektet negative mbi personat me aftësi të kufizuara. Komisioneri konstaton se ky pretendim nuk gjen mbështetje as në fakte dhe as në kuadrin ligjor të zbatueshëm.

Neni 3, pika 9, i LMD-së përcakton se *“Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuar.”*

Nga formulimi i kësaj dispozite rezulton se mohimi i përshtatjes së arsyeshme, si formë e veçantë diskriminimi, kërkon që personi i interesuar me aftësi të kufizuara të ketë paraqitur një kërkesë konkrete të cilën punëdhënësi e ka kundërshtuar ose ka refuzuar të veprojë. Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës nuk rezulton që ankuesi të ketë paraqitur ndonjëherë kërkesë pranë SHRUKD-së për marrjen e masave konkrete për sigurimin e përshtatjes së arsyeshme. Në mungesë të një kërkesë të tillë, nuk mund të flitet për "mohim" apo "kundërshtim" në kuptimin e nenit 3, pika 9, të LMD-së, pasi nuk ka pasur kërkesë ndaj të cilës punëdhënësi të ketë kundërshtuar. Rrjedhimisht, ankuesi nuk mund të pretendojë mohim të përshtatjes së arsyeshme si formë e veçantë diskriminimi.

Lidhur me pretendimet e ankuesit për pagën e muajit nëntor 2025

Ankuesi pretendon se mospagimi i pagës së plotë për muajin nëntor 2025 përbën diskriminim të drejtpërdrejtë dhe viktimizim, duke argumentuar se ka qenë i pranishëm në vendin e punës dhe se shoqëria ka refuzuar të njohë praninë e tij faktike. Shoqëria kundërshton këtë pretendim, duke u mbështetur në listëprezencën e muajit nëntor 2025, regjistrat elektronikë të hyrje-daljeve, urdhrat e punës dhe procesverbalet e Njesisë Task Forcë, të cilat ankuesi nuk i ka firmosur.

Komisioneri vlerëson se çështja e mungesës dhe e mospagimit të pagës për muajin nëntor 2025 nuk mund të shqyrtohet e shkëputur nga konfuzioni administrativ i krijuar nga urdhrat e lëshuar gjatë kësaj periudhe lidhur me statusin profesional të ankuesit. Konkretisht, ankuesi ishte formalisht i transferuar pranë Njesisë Operacionale Nr. 2 me urdhrin nr. 498, datë 05.11.2025, me efekt nga data 06.11.2025, ndërsa ky urdhër u revokua me urdhrin nr. 498/1, datë 14.11.2025. Ky kontekst administrativ është vlerësuar i rëndësishëm veçanërisht për periudhën 06–14 nëntor 2025.

Nga vlerësimi i akteve, rezulton se, për periudhën 03–05.11.2025, ankuesi duhej të ishte pranë Task Forcës, por nuk provohet paraqitja në detyrë. Për periudhën 06–14.11.2025, pavarësisht transferimit, regjistri elektronik i hyrje-daljeve, mjet i pavarur nga struktura organizative, nuk pasqyron asnjë regjistrim as pranë Njesisë Operacionale Nr. 2. Për periudhën 17–21.11.2025, ka regjistrime elektronike, por pa plotësim të orarit të reduktuar prej 6 orësh dhe pa firmë në urdhrat/procesverbalet e Task Forcës, çka tregon prani vetëm fizike e jo në ushtrim funksioni (data 24.11.2025 nuk ka asnjë regjistrim). Për datat 25–26.11.2025, ka regjistrime të pjesshme, ndërsa data 26.11.2025 figuron me raport mjekësor të vlefshëm dhe është pasqyruar si e tillë, jo si mungesë.

Mungesat e pajustificuara nuk krijojnë të drejtë për përfitim page sipas këtyre dispozitave, dhe në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se llogaritja e pagës për muajin nëntor 2025 në vlerën 5.885 lekë bruto, e cila përfshin vetëm pagesën e raportit mjekësor të vlefshëm për datat 26–30 nëntor 2025, është kryer në mënyrë të rregullt. Komisioneri evidenton gjithashtu faktin se punëdhënësi, pavarësisht mungesave të pajustificuara, nuk ka ndërmarrë asnjë masë disiplinore ndaj ankuesit. Pavarësisht se paga e ankuesit, bazuar në marrëdhënien kontraktuale midis palëve, është 80.000 lekë, mungesat e pajustificuara nuk krijojnë të drejtë page, dhe për këtë arsye paga e ankuesit për muajin nëntor është përlogaritur vetëm në vlerën e pagueshme të raporteve mjekësore, rreth 5.885 lekë.

Lidhur me deklarin e kontributeve mbi pagën minimale prej 40.000 lekësh, Komisioneri konstaton se shoqëria ka vepruar në përputhje me nenin 9 dhe nenin 10 të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilave kontributi llogaritet dhe paguhet mbi pagën bruto, brenda kufijve të pagës minimale në shkallë vendi, dhe kontributi minimal llogaritet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi, e cila, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, në fuqi në atë kohë, është 40.000 lekë. Në kushtet kur paga e llogaritur e ankuesit për muajin nëntor 2025 ka qenë më e ulët se paga minimale, deklarimi i kontributeve në vlerën 40.000 lekë nuk përbën deklarin fiktiv, por zbatim të detyrimit ligjor. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e punëdhënësit/SHRUKD.

Ankuesi ka vijuar punën në pozicionin “Inspektor” pranë Njesisë Task Forcë deri në datën 20.05.2026, moment në të cilin marrëdhënia e punës ka përfunduar bazuar në kërkesën e ankuesit, si pasojë e daljes në KEMP.

Përfundimisht, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson ankuesi nuk është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e punëdhënësit/SHRUKD. Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri nuk konstaton shkelje të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e punëdhënësit/ SHRUKD.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit z.V.Ç në të drejtën për punësim nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a, për shkaqet e diskriminimit të pretenduara “*gjendja shëndetësore*”, “*aftësia e kufizuar*” dhe “*bindje politike*”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

Shkaku: Aftësia e kufizuar, bindje politike, gjendje shëndetësore
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim